



## VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE I SHOQËRISË "MEDIA 6" SHPK

Sot më datë 25.04.2000 u mbledh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e ortakëve të Shoqërisë "Media 6" sh.p.k.

"Media 6" Shpk është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941 date 12 Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skëndaj zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Merr drejtimin e mbledhjes Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kanë marre me parë njoftim ortakët:

1. Deklarimin e shdërrimit të formës së Shoqërisë;
2. Miratim i raportit të ekspertit për kontributet në shoqëri për shdërrimin e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
3. Emetimi i aksioneve të reja, nënshkrimi dhe pagimi i tyre
4. Diskutimi dhe miratimi i statutit të ri të shoqërisë;

### 1. DEKLARIMI I SHDËRRIMIT TË FORMËS SË SHOQËRISË

Z. Aleksandër Frangaj deklaroi se sic edhe ishin në dijeni ortakët me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Në bazë të vendimit të asamblesë së datës 28.3.2000 ishte vendosur edhe eksperti për kontributet në shoqëri. Ai u kërkoi ortakëve të deklaronin shdërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

### 2. MIRATIM I RAPORTIT TË EKSPERTIT PËR KONTRIBUTET NË SHOQËRI PËR SHDËRRIMIN E SAJ NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se në vijim të mbledhjes së asamblesë së ortakëve datë 28.3.2000 shoqëria ka proceduar me fazën e parë të shdërrimit të saj në shoqëri anonime. Me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, datë 5.4.2000 nr. 16941/2 është miratuar caktimi i ekspertit për kontributet. Në vijim eksperti ka përpiluar dhe



depozituar pranë shoqërisë aktin e ekspertimit i cili i është vënë në dispozicion të pranishmëve në asamble që në datën 21.04.2000. Në këtë raport eksperti ka paraqitur tre variante për transformimin në shoqëri anonime dhe rritjen e kapitalit të shoqërisë: variantin minimal, atë optimal dhe atë maksimal. Z. Frangaj vuri në dijeni se eksperti ka përcaktuarin kufirin minimal dhe maksimal dhe se është në të drejtën e ortakëve të caktojnë brenda këtyre kufijve se sa do të jetë kapitali i shoqërisë.

Pas një diskutimi të hollësishëm të pranishmit me unanimitet vendosën:

Rritjen e kapitalit të shoqërisë në 12,000,000 dymbëdhjetë milionë lekë duke i shtuar kapitalit aktual prej 100,000 shumën prej 11,900,000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqindmijë) lekë.

### 3. EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA, NËNSHKRIMI DHE PAGIMI I TYRE.

Z. Frangaj i propozoi Asamblesë që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,900 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila dhe i ftoi ata të deklaronin numrin e aksioneve që do të nënshkruanin paguanin secili.

Pas në diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimitet vendosën që rritja e kapitalit të bëhej nëpërmjet emetimit të 11,900 aksioneve të reja me vlerë prej 1,000 lekë secila. Dhe deklaruan se do të nënshkruanin përkatësisht këto aksione:

Z. Julien Roche do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;  
Z. Marsel Skënde do të nëshkruajë 3975 aksione me një vlerë prej 3,975,000 lekë;  
Z. Aleksander Frangaj do të nëshkruajë 3950 aksione me një vlerë prej 3,950,000 lekë.

Pagesa e aksioneve u bë menjëherë duke ulur proporcionalisht detyrimet e shoqërisë ndaj ortakëve dhe më hollësisht:

Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Julien Roche u ulën me 3,975,000 lekë;  
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Marsel Skëndaj u ulën me 3,975,000 lekë;  
Detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut Aleksandër Frangaj u ulën me 3,950,000 lekë.

Që nga ky moment struktura e shoqërisë është si më poshtë

- Julien Roche zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Marsel Skëndaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë);
- Aleksandër Frangaj zotëron 4,000 (katërmijë) me një vlerë prej 4,000,000 (katërmilionë lekë).

### 4. DISKUTIMI DHE MIRATIMI I STATUTIT TË RI TË SHOQËRISË






Z. Frangaj shpjegoi se për shkak të ndryshimit të formës së shoqërisë duhej të kryeshin një sërë ndryshimesh në statutin e saj për pa bërë atë konform me ligjin 7638 date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për Radion dhe televizionin në Republikën e Shqipërisë. Kështu duhej të ndryshoheshin objekti, kapitali, organet drejtuese, mënyra e funksionimit dhe marrjes së vendimeve të shoqërisë, si dhe kontrolli ekonomik i saj. Për këtë arsye është hartuar një version i statudit të shoqërisë në të cilin janë pasqyruar të tëra ndryshimet e kërkuara nga ligji dhe propozime të tjera të ortakëve. Variantin përfundimtar të statudit Z. Frangaj e lexoi me zë të lartë në asamble.

Pas një diskutimi të hollësishëm dhe të gjatë ortakët vendosën me unanimitet miratimin e statudit të ri të shoqërisë në formën që i bashkëngjitet këtij dokumenti. Z Frangaj u ngarkua të kryente të tëra procedurat e nevojshme pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për shdërrimin e formës së shoqërisë dhe depozitimin e statudit të ri.

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

#### ORTAKËT

  
\_\_\_\_\_  
Julien Roche  
\_\_\_\_\_  
Marsel Skëndaj  
\_\_\_\_\_  
Aleksandër Frangaj